

E ENJTE DATA 23 SHKURT 2023

## FJALA E DEPUTETES FLUTURA AÇKA

Të parën gjë që kam, po e them të parën, se kam tri çështje të tjera që lidhen me Kushtetutën dhe shkeljet që janë bërë që nga 22 dhjetori në këtë vend, në këtë “peizazhin fajtor”, siç e kanë quajtur, jo unë, por disa burra më të mençur: parlamenti këtu nuk nis asnjëherë në orarin e caktuar. Unë nuk e kuptoj, zonja Kryetare. Meqenëse jemi “kopsht zoologjik”, sipas terminologjisë që na ka përcaktuar kryetari juaj, kontrolloni njëherë “kafazin” tuaj që të jetë këtu, të paraqitet në orar këtu, si e gjithë Europa, si e gjithë bota, ku parlamenti nis në orën e përcaktuar. Për të kaluar te çështjet e mia të procedurës, po them dy të parat dhe do të kaloj tek e treta, që është edhe më flagrante se dy të tjerat. Çështja e parë, që është përsëritur këtu, është çështja përse Kryeministri nuk paraqitet në kohë sa herë e kërkojnë ose kur e kërkon Kushtetuta, sipas kësaj? Kjo Kushtetuta këtu nuk është e madhe për të trembur demin e tërbuar të opozitës, por është detyrim për secilin prej nesh për t’u zbatuar; zonja Kryetare, është edhe me ngjyrë të kuqe, falë Zotit. Ju keni shkelur nenin 80 të Kushtetutës, duke mos e sjellë këtu në kohë. Ndoshta për ju, Kryeministri është Skënderbe, Zeus, Promete. Për ne është Kryeministri i shqiptarëve, madje nuk na intereson fare emri i përveçëm, por na intereson Kryeministri si institucion. Të vijë këtu dhe të japë llogari, atëherë kur e kërkon opozita. Por meqenëse na ka deklaruar nëpër televizione se jemi “kopsht zoologjik”, se do të vijë këtu kur t’i pëlqejë atij dhe jo kur e thotë Kushtetuta, zgjidheni vetë se kush është tani pilivesa, kush është mëshqerra e kush është qelbësi në këtë parlament.

Për veten time, e di që vij erë njeriu. Kështu që, unë dhe shumë të tjerë do të flasim si njerëz këtu, ndërsa sa për Kryeministrin, i bie, meqenëse jemi në zoo, të jetë hiena. Në fakt, është hiena, siç thotë Xhonatan Franzen: “Edhe hiena ka integritet, por hienë është prapë”. Të kaloj te pika e dytë. Kjo është shkelja e parë, zonja Kryetare. Pika 2, komisioni hetimor. Këtu sapo u tha një gjë e pavërtetë. Ju keni gjetur vjega, “firma e këtij, firma e atij”. Sa kohë që deputeti deklaroi publikisht që firma është e tij (dhe çdo njeri ka të drejtë ta ndryshojë firmën brenda ditës, sa herë të dojë), por, kur e deklaroi publikisht “është firma ime”, nuk ka asnjë konflikt. Ju do të merreni me verifikimin e firmave të njerëzve, kur deputeti e thotë publikisht: “Është firma ime” dhe me 44 firma, ju nuk hapni... (Bie gongu.) ...komisionin hetimor? Ju kapeni me vjega, jo Konferenca e Kryetarëve, që nuk ka asnjë mandat ta caktojë këtë... Është kjo, zonja Kryetare, dhe keni shkelur nenin 77. Kalojmë te pika e tretë (që është edhe më flagrante në sytë e mi), ju keni shkelur nenin 71, ku thuhet: “Kushdo deputet i parlamentit ka të drejtën e përfaqësimit” të atyre njerëzve që janë mbrapa tij. Ju, edhe sikur t’i përjashtoni, dhe keni përjashtuar, tani sa mora evidencën, 27 deputetë nga data 22 dhjetor! Ju u keni hequr ligjeve 27 vota, nga data 22 dhjetor deri sot! Nuk e keni këtë mandat ta bëni këtë. Mund t’i hiqni nga parlamenti, por në momentin e votimit ju jeni të detyruar t’i ftoni të votojnë, se nuk e keni ju këtë mandat, e kanë të tjerë njerëz që janë përjashta, ata që ua kanë dhënë mandatin këtyre njerëzve!

Dhe, si e gjithë Europa, zonja Kryetare, në atë momentin e votimit duhet t’i ftoni në sallë dhe të vijnë të votojnë. Ajo evidencë atje nuk është e saktë, është e gënjeshtërt, sepse këta njerëz nuk e kanë thënë votën e tyre, qoftë edhe atë kundër. Kështu, nga data 22 dhjetor, të gjitha ligjet janë nul. Unë i bëj thirrje Presidentit të Republikës t’i kthejë këto ligje, që këto ligje t’i nënshtrohen diskutimit dhe votimit këtu, sepse është shkelje flagrante! Kaq kisha unë.